



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

PROKURORIA THEMELORE

Zyra e Kryeprokurorit

AD.nr.1/2025

Më datë: 06 shkurt 2025

Gjilan

Në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan si autoritet kompetent, merr këtë:

V E N D I M

HUDHET, ankesa e paraqitur nga pala ankuese [REDAKTUAR], për shkelje disiplinore ndaj prokurores [REDAKTUAR]

Arsyetimi

Më datë 22 Janar 2025, kemi pranuar ankesën për shkelje disiplinore nga prokurorja [REDAKTUAR] në trajtimin e rastit me nr. [REDAKTUAR], për shkak të veprave penale "Cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve", "Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë" dhe "Vetëgjyqësia", të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas pretendimeve të paraqitura nga pala ankuese [REDAKTUAR]

Më datë 28 Janar 2025, konform nenit 9 par. 5 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, është njoftuar Këshilli Prokurorial i Kosovës, për pranimin e ankesës nga pala ankuese [REDAKTUAR]

[REDAKTUAR] e ankesë pretendon se në rastin me numër të Prokurorisë Themelore në Gjilan [REDAKTUAR] dhe numër të Policisë [REDAKTUAR] prokurorja kujdestare [REDAKTUAR] nuk ka trajtuar rastin me profesionalizëm, pasi që sipas tij në këtë rast për shkak të acarimit të raporteve të vazhdueshme familjare ka qenë e mundur që të vinte deri tek rrahja apo vrasja.

Më tutje në ankesë i njëjti pretendon se prokurorja e rastit nuk ka ndërmarrë masat përkatëse siç janë arrestimi i të dyshuarve, marrja e çelësit të lokalit nga personat e dyshuar dhe që ndaj të dyshuarve të kërkohet masa e paraburgimit, pasi sipas të njëjtit biznesi i tij – [REDAKTUAR], rrezikon të mbyllet nga Ministria për Infrastrukturë, Hapësirë dhe Planifikim për shkak të mosfunksionimit dhe operimit, për shkak të mos kryerjes së obligimeve për kandidatët e pranuar për përgatitje të marrjes së patentë shoferit.

Pas pranimit dhe analizimit të ankesës së paraqitur nga pala ankuese [REDAKTUAR] me qëllim të verifikimit të këtij dyshimi, kemi kërkuar rastin me numër [REDAKTUAR] dhe pas vlerësimit të tyre kemi konstatuar këtë gjendje:

Ky rast është raportuar në polici më datë 13 Janar 2024, me nr. të policisë [REDAKTUAR], i cili fillimisht ishte raportuar për dhunë në familje dhe të njëjtit janë shoqëruar në stacion policor për intervistim. Gjatë deklaratës në polici [REDAKTUAR] ka deklaruar se vëllau i tij [REDAKTUAR] ka hyrë në lokalin, i cili pretendon se është i tij – [REDAKTUAR], ia nxjerrë jashtë të gjithë inventarin dhe ka mbyllë lokalin.

Ndërsa, vëllau i tij – [REDAKTUAR], i cili është intervistuar në prezencë të interpretit (shurdh-memecë), ka deklaruar se ia ka hequr sendet nga lokali në mënyrë paqësore dhe se e kishte paralajmëruar për këtë gjë, pasi që tatimin e pronës, ujin dhe energjinë elektrike e paguan i njëjti, mirëpo e shfrytëzon vëllau i tij [REDAKTUAR] dhe se për këtë pronë nuk kanë vendim nga Gjykata.

Policia pas konsultimit me prokuroren kujdestare [REDAKTUAR] e cila iu ka përgjigjur të gjitha komunikimeve të policisë, ka konstatuar se rasti nuk ka të bëjë me "Dhunë në familje" dhe ka udhëzuar që të inicohet si "Cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve", që në këtë çështje të ndërmerren veprime tjera hetimore dhe pas kompletimit rasti të referohet me kallëzim penal në Prokurorinë Themelore në Gjilan – Departamenti Përgjithshëm.

Prokuroria Themelore në Gjilan, më datë 17 Janar 2025 ka pranuar kallëzimin penal nga policia e Kosovës me numër [REDAKTUAR] ndaj të dyshuarve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] i cili sipas radhës është ndarë në punë në Departamentin e Përgjithshëm, tek prokurori [REDAKTUAR] ku i njëjti pas analizimit të shkresave ka vlerësuar se kjo çështje përpos veprave penale "Cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve" dhe "Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë", ka të bëjë edhe me veprën penale "Vetëgjyqësia".


Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti Përgjithshëm, më datë 31 Janar 2025 ka ngritur aktakuzën ndaj të pandehurve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer këto vepra penale:

- "Cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve" nga neni 197 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK),
- "Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë" nga neni 321 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe,
- "Vetëgjyqësia" nga neni 410 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Po ashtu, më datë 28 Janar 2025, parashtruesi i ankesës [REDAKTUAR] është pritur në Zyrën e Kryeprokurorit dhe i njëjti është njoftuar për ecurinë e procedurës dhe po ashtu është udhëzuar që sa i përket zgjidhjes së kontestit të dorëzojë në gjykatë padi për pengim posedimi, meqë prokuroria nuk ka ndonjë mekanizëm e as mundësi ligjore që ta liroj objektin nga personat dhe sendet.

Pas analizimit të rastit, konsiderojmë që prokurorja e shtetit [REDAKTUAR] ka vepruar në kuadër të kompetencave të saj dhe rastin e ka trajtuar me profesionalizëm, pavarësi dhe paanshmëri, duke udhëzuar Policinë e Kosovës që ndaj të dyshuarve të ushtrohet kallëzim penal, i cili është trajtuar në afat optimal dhe ka rezultuar me aktakuzë në Gjykatën Themelore në Gjiilan, pra në veprimet e prokurores nuk është identifikuar asnjë shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të detyrave të saj.

Andaj bazuar në dispozitat ligjore dhe arsyet faktike të cilat u cekën më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

 **KRYEPROKURORI**
Arben Kadriu

Kopje/njoftim konform nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjiqtarëve dhe Prokurorëve:

- 1x1 kopje [REDAKTUAR];
- 1x1 kopje, [REDAKTUAR];
- 1x1 kopje, arkivës.